

**Numri:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrës parashtrues:** Mbrojtësi i specializuar për Kadri Veselin

**Data:** 9 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Titulli i dosjes:** Publike

**Klasifikimi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

---

**Parashtrime në emër të Kadri Veselit**  
**Konferenca mbi ecurinë e çështjes - e mërkurë 18 nëntor**

---

**Zyrës së Prokurorit**  
**Të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të specializuar**  
të të akuzuarit Kadri Veseli  
Ben Emerson CBE QC

## I. PYETJE TË PËRGJITHSHME

1. Në përgjigje të pyetjes 1(d), Mbrojtja e z. Veseli kërkon një periudhë prej të paktën 18 muajsh që nga koha kur ZPS-ja të ketë nxjerrë të gjitha materialet, në mënyrë që të mund të hetojë plotësisht secilën nga veprat e pretenduara në Aktakuzë, dhe provat ku Prokuroria është mbështetur për të ngritur akuzat për ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe për përgjegjësinë komanduese.
2. Në akuzat e ngritura nga ZPS-ja përfshihen një numër i madh veprash penale të veçanta, që supozohet se janë kryer nga individë të shumtë, përgjatë një periudhe të zgjatur, në të gjithë territorin e Kosovës dhe në disa pjesë të Shqipërisë. Hetimi i këtyre veprave penale të supozuara mund të fillojë me seriozitet vetëm pasi ZPS-ja të ketë vënë në dispozicion provat mbi të cilat synon të mbështetet për secilën prej tyre.
3. Në mënyrë që të akuzuarit t'i sigurohet e drejta e tij për kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, do të jetë e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të monitorojë nga afër procesin e nxjerrjes dhe redaktimit të materialeve, për të siguruar që Mbrojtja të ketë mundësi të arsyeshme që të identifikojë incidentet në fjalë dhe pjesëmarrësit e pretenduar me konkretësi të mjaftueshme, për të qenë në gjendje të kryejë hetime efektive të provave për krimet.
4. Nga përvoja e kohës së shkuar, është e mundur që Mbrojtjes do t'i duhet të paraqesë kërkesa për heqjen e redaktimeve nga deklaratat e dëshmitarëve kryesorë, në mënyrë që të mund të identifikohen incidentet dhe dëshmitarët, që provat të mund të testohen në mënyrë efektive dhe që të mund të kryhen hetime të plota. Kjo është më e mundshme nëse ZPS-ja lejohet që të

vetautorizojë redaktimet sipas kategorisë, me autoritet specifik gjyqësor paraprak. Nxjerrja e mjaftueshme e informacionit të prej të cilit hiqen redaktimet do të jetë thelbësore për të siguruar që procesi i gjyqimit të respektojë parimet e drejtësisë themelore procedurale dhe për të garantuar barazinë e duhur të palëve.

5. Nxjerrja e materialeve nga ana e ZPS-së do të bëhet në paketa. Në këtë mënyrë do të ketë një dialektikë ndërmjet shtrirjes dhe efikasitetit të nxjerrjes së materialeve dhe procesit të heqjes së redaktimeve nga ana e ZPS-së dhe efektivitetit të hetimit të Mbrojtjes. Sa më shpejt që ZPS-ja të nxjerrë dëshmitë e dëshmitarëve, të paredaktuara apo ato nga të cilat janë hequr redaktimet, aq më shpejt do të mundet edhe Mbrojtja t'i hetojë ato. Megjithatë, si një parim i përgjithshëm, duhet kuptuar nga të gjithë që Mbrojtja nuk do të jetë në gjendje të hetojë si duhet një pretendim, derisa t'i jepet njoftimi i duhur mbi veçoritë e ngjarjeve dhe personave të dyshuar të përfshirë.
6. Në këtë kontekst, kalendari i diskutuar nga ZPS-ja është jorealit. Parashtrimi i ZPS-së për këtë seancë sugjeron se nxjerrja e materialeve do të përfundojë deri dikur nga maji 2021, me supozimin se gjykimi do të fillonte së shpejti pas kësaj. Kjo qasje nuk merr parasysh barrën e konsiderueshme hetimore që do të bjerë mbi Mbrojtjen, pasi të jetë kryer nxjerrja e plotë e materialeve. Për këtë arsye, edhe nëse ZPS-ja i përmbahet zotimit të saj për të bërë nxjerrjen e plotë të materialeve deri në maj 2021, koha më e hershme se kur do të mund të fillonte gjykimi do të ishte qershori 2022.
7. Bazuar në gjykimet e Kosovës në TPNJ, me një shtrirje në masë të konsiderueshme më të vogël, një periudhë prej 12 muajsh pas përmbushjes së

plotë të detyrimit të nxjerrjes së materialeve prej ZPS-së, është periudha minimale që do të mund t'i siguronte kohë dhe mundësi të përshtatshme Mbrojtjes. Duhet të kihet parasysh se ZPS-ja ka kaluar pesë vjet duke hetuar këto akuza, me kapacitete shumë më të mëdha sesa ato që janë në dispozicion të Mbrojtjes. Hetimet paraprake nga ana e Mbrojtjes mund të fillojnë pas nxjerrjes së paketës së parë të materialeve, por baza e provave do të evoluojë me dorëzimin e provave të tjera shtesë, me heqjen e redaktimeve fillestare si dhe me zhvillimin e hetimeve të mëtejshme nga ana e ZPS-së.

8. Si rrjedhim, Mbrojtja nuk është në gjendje të parashikojë një datë reale për fillimin e gjyqimit përpara qershorit 2022. Varësisht nga rrethanat, mund të jetë e nevojshme që gjyqimi të fillojë edhe pas kësaj date.
9. Sa i përket kohëzgjatjes së gjyqimit, përvoja e TPNJ-së tregon se nëse menaxhohet me vendosmëri, mund të jetë e mundshme që gjyqimi të përfundohet brenda një periudhe prej 18 muajsh. Sidoqoftë, mund të marrë edhe më shumë kohë, duke pasur parasysh që ZPS-ja vlerëson se do të jenë përafërsisht 200 dëshmitarë dhe janë katër të akuzuar, ku secilit prej tyre duhet t'i caktohet kohë për paraqitjen e mbrojtjes së vet. Pasi të jetë përmbyllur procedura e paraqitjes së provave dhe të jenë bërë parashtrimet përmbyllëse, atëherë ka të ngjarë që do të ketë një periudhë tjetër të nevojshme për trupin gjykues për të analizuar provat, diskutuar dhe për të hartuar aktgjykimin.
10. Rrjedhimisht, ka të ngjarë që ky proces të zgjasë së paku katër vjet nga tani për të arritur në një përfundim, dhe ndoshta, edhe deri në pesë vjet. Kundrejt këtyre rrethanave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të duhet të marrë në shqyrtim

çdo kërkesë të Mbrojtjes për lirim të përkohshëm me kusht në pritje të gjyqimit (për këtë shiko paragrafin 15 më poshtë).

## II. MBROJTJET DHE ARSYET PËR PËRJASHTIMIN E PËRGJEGJËSISË PENALE

11. Në përgjigje të pyetjes 1(e), Mbrojtja e z. Veseli rezervon të drejtën e vet lidhur me çdo mbrojtje konkrete ku mund të mbështetet, të tilla si *alibia*, dhe do të veprojë në përputhje me detyrimet e saj të njoftimit në kohën e duhur.

12. Pavarësisht nga ky qëndrim, mbrojtja e z. Veseli paraqet vullnetarisht deklaratën e mëposhtme lidhur me “arsyet e tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale”. Janë pesë pika që përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe që z. Veseli dëshiron që të shënohen që në fillim në procesverbal:

- a. **Pika e parë:** Në masën që ZPS-ja është në gjendje të provojë kryerjen e krimeve të veçanta nga individë që ishin (ose që pretendohet se ishin) pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç pretendohet në Aktakuzë, grumbullimi i atyre krimeve individuale nuk vërteton ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Nuk ka ekzistuar asnjë ndërmarrje e përbashkët kriminale siç pretendohet në Aktakuzë dhe nuk ka asnjë bazë tjetër ligjore për ta bërë z. Veseli përgjegjës për veprat penale të personave të tjerë, të pretenduara në Aktakuzë.
- b. **Pika e dytë:** Në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare, konteksti është gjithçka. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një kryengritje popullore kryesisht spontane dhe minimalisht e organizuar që veprroi në

mbrojtje të popullatës civile shqiptare përballë një fushate të planifikuar me kujdes të krimeve kundër njerëzimit, që mund të themi arriti deri në nivelin e tentativës për gjenocid, të ashtuquajturit krim mbi krimet. Më shumë se 10.000 shqiptarë të Kosovës u vranë nga forcat e kombinuara serbe në masakra të shumta të planifikuara ndërkohë që vendi ra në kaos, paligjshmëri dhe në një luftë civile krejtësisht asimetrike. Ata u varrosën në varre masive nga forcat serbe dhe shumë prej tyre u zhvarrosën më pas dhe kufomat e tyre u dërguan në Serbi, ku u fshehën për të mbuluar kështu krimet e tmerrshme masive që kishin ndodhur. TPNJ-ja ka dënuar gjashtë drejtues ushtarakë dhe policorë serbë të rangut të lartë për rolin e tyre në planin e koordinuar për të spastruar etnikisht Kosovën nga popullata e saj civile shqiptare, përmes kryerjes së krimeve kundër njerëzimit në shkallë të gjerë, me qëllimin e shprehur qartë të nxjerrjes jashtë vendit të pothuaj gjithë popullatës etnike shqiptare përtej kufijve për në Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri. Të pretendosh ndonjë lloj barazimtarie ndërmjet këtij komploti të organizuar kriminal dhe veprimeve të gabuara të kryera nga disa prej pjesëtarëve të komunitetit të sulmuar është një shtrembërim i fakteve dhe një përmbysje e realitetit në terren. Kur provat e ZPS-së të shihen në kontekstin e tyre të plotë, kjo Aktakuzë do të shihet si një shpërfytyrim i të vërtetës.

- c. **Pika e tretë:** Objektivi i përbashkët i UÇK-së ishte vetëmbrojtja. Në kontekstin e një sulmi të koordinuar dhe të vazhdueshëm nga forcat e armatosura të rregullta të kombinuara të RSFJ-së, civilët shqiptarë të Kosovës që kishin marrë armët u munduan të organizoheshin mes tyre, fshat më fshat, në një lloj force luftarake për të mbrojtur komunitetet e tyre. Në këtë kontest, pati akte sporadike dhe të çrregullta të rezistencës

së armatosur. Është pa dyshim gjithashtu e vërtetë se në trazirën politike dhe në pëstjellimin ushtarak që përfshiu gjithë vendin u kryen disa krime nga disa individë. Ato krime ishin të pajustificueshme. Por ato ishin krime individuale në një shkallë të vogël, në krahasim me masakrën sistematike të shkallës industriale që u krye kundër shqiptarëve etnikë nga RSFJ-ja. E vetmja ndërmarrje e përbashkët që ekzistoi brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte ndërmarrja e përbashkët për të mbrojtur popullatën civile ndaj krimeve që po kryheshin nga ana e RFSJ-së. Nuk kishte asnjë qëllim të përbashkët për të arritur objektivin e tyre përmes kryerjes së krimeve kundër civilëve. E kundërta është e vërtetë. Fitoret modeste dhe në fakt edhe vetë ekzistenca e UÇK-së vareshin nga pëlqimi dhe mbështetja e vazhdueshme e njerëzve të Kosovës. Kjo nuk është diçka që ata do të mund të kishin shpresuar të arrinin, ose që do të mund të kishin arritur, nëse do të kishin zbatuar një ndërmarrje të përbashkët për të kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Këta të ashtuquajturit udhëheqës ishin komandantët e burrave dhe grave, të cilët, në një moment të caktuar zgjodhën t'u shkonin pas. Ata ishin bujq gjatë ditës dhe ushtarë vullnetarë gjatë natës. E vetmja gjë që ata kishin të përbashkët ishte qëllimi i përbashkët për të vepruar në vetëmbrojtje të komunitetit të tyre.

- d. **Pika e katërt:** Aspekti i qëllimit të përbashkët është marrë në shqyrtim edhe më parë në këtë kontekst, gjatë dy gjykimeve të zgjata në TPNJ. TPNJ-ja ka konkluduar më herët se në kontekstin e veçantë të UÇK-së, një grumbullim i krimeve individuale të kryera gjatë periudhës që përfshin Aktakuza nuk mund të barazohet me një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Kryerja e krimeve të tilla nuk provon as me deduksion ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.

Mbrojtja e z. Veseli do të mbështetet në këto konstatime si konkluzione bindëse faktike dhe ligjore të pleksura bashkë.

- e. **Pika e pestë:** Së fundi, provat do të vërtetojnë se niveli i organizimit operativ dhe linjat e autoritetit dhe komunikimit brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjatë periudhës që përfshin Aktakuza, ishin aq pak të zhvilluara, saqë është e pamundur të pohosh apo të provosh bazën ligjore për të justifikuar mbështetjen e ZPS-së në doktrinën e përgjegjësisë komanduese. Ky pozicion është njohur shprehimisht nga Prokurori i TPNJ-së, pas një hetimi në shkallë të gjerë.

### III. NXJERRJA E MATERIALEVE, REDAKTIMI DHE SISTEMI TABELOR

13. Mbrojtja e z. Veseli merr shënim kalendarin e propozuar nga ana e ZPS-së dhe momentalisht nuk ka ndonjë vërejtje për të bërë në lidhje me këtë temë. Mbrojtja konsideron se ZPS-së duhet t'i jepet një mundësi e drejtë për të përmbushur detyrimet e saj në mënyrën e propozuar, dhe ruan të drejtën për të paraqitur parashtrime të mëtejshme gjatë konferencës së radhës mbi ecurinë e çështjes mbi bazën e përvojës.

14. Për sa i takon tabelës së propozuar, Mbrojtja e z. Veseli merr shënim qëndrimet e shprehura nga ZPS-ja dhe nga të akuzuarit e tjerë dhe nuk ka asgjë për të shtuar në këtë fazë. Sërish, ky qëndrim mund të ndryshojë mbi bazën e përvojës.



#### IV. LIRIMI I PËRKOHSHËM NË PRITJE TË GJYKIMIT

15. Z. Veseli bën kërkesë zyrtare për lirim të përkohshëm në pritje të gjyqimit dhe fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të caktojë një afat për shkëmbimin e parashtrimeve me shkrim, që më pas do të pasohet nga një seancë e shkurtër gojore, përveçse nëse ai mendon të miratojë lirimin e përkohshëm vetëm mbi bazën e parashtrimeve me shkrim. Rendi i paraqitjes së parashtrimeve me shkrim është çështje e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, përveç rastit nëse ekziston një supozim i fortë në favor të lirimin të përkohshëm në pritje të gjyqimit, që rrjedh nga neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca në përputhje me të. Detyrimi i përligjes së paraburgimit i takon ZPS, dhe mund të përmbushet vetëm duke iu referuar faktorëve konkretë dhe të identifikuar në lidhje me të akuzuarin përkatës, dhe me kusht që ZPS-ja të jetë në gjendje të përcaktojë saktësisht se si do të parandalohet ndonjë rrezik i caktuar duke e mbajtur të akuzuarin në paraburgim përgjatë gjithë procedimit (që sipas gjasave, në realitet, mund të zgjasë katër deri në pesë vjet), përkundër zbatimit besnik të parimit të supozimit të pafajësisë. Rrjedhimisht, pasi ZPS-ja të ketë përcaktuar kundërshtimet ndaj lirimin të përkohshëm, Mbrojtjes duhet t'i jepet një mundësi e përshtatshme që të përgjigjet

**Numri i fjalëve (në origjinal): 2001**

\_\_\_\_\_/nënshkrim/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Ben Emerson**

**Mbrojtës i specializuar për Kadri Veselin**

E martë, 17 nëntor 2020  
Në Hagë, Holandë.